



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



ZYRA PËR REGJISTRIMIN, CERTIFIKIMIN DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË SUBJEKTEVE POLITIKE (Zyra) NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ) sipas autorizimeve të dhëna me paragrafin 1 të nenit 21 dhe në përputhje me nënparagrafin 7, paragrafi 6 të Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP), me datën 11.07.2024, merr këtë:

VENDIM

Për shqiptimin e gjobës për subjektin politik PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM

- I. Subjektit politik PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM, i shqiptohet gjoba në vlerë katër mijë (4,000) euro për shkeljen sipas nënparagrafit 7, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.
- II. Subjekti politik PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM, obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij vendimi, të paguaj shumën e gjobës së shqiptuar sipas pikës I të këtij vendimi dhe të dorëzojë në Zyrës një kopje të fletëpagesës së gjobës së paguar.
- III. Nëse subjekti politik PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM, nuk paguan gjobën brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit të Zyrës, subjektit politik nuk i transferohen mjetet financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politik në shumë e gjobës së shqiptuar.
- IV. Vendimet e Zyrës për shqiptimin e gjobave hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme.

Arsyetim

Subjekti politike PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM, është subjekt politik i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi nga data 05.11.2010.

Sipas nenit 19 të LFSP ku theksohet qartë subjekti i regjistruar politik bashkëpunon ngushtë me auditorët e përzgjedhur nga Zyra dhe u ofron atyre qasje të plotë dhe të papenguar në shënimet financiare të subjektit, duke përfshirë të gjitha shënimet pa kufizime.

Në ndërlidhje të obligimit që del nga ky nen, subjekti politik ka dështuar në ofrimin dokumentacion mbështetës për të hyrat dhe shpenzimet e prezantuara për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, që ishte objekt auditimi, edhe pas kërkesave të përsëritura nga auditorët. Si pasojë, auditorët kanë konstatuar mos-bashkëpunimin e subjektit politik gjatë procesit të auditimit.

Mos bashkëpunimi ngushtë me auditorët e përzgjedhur nga Zyra dhe dështimi për të ofruar atyre qasje të plotë dhe të papenguar në shënimet financiare të subjektit, duke përfshirë të gjitha shënimet pa kufizime paraqet shkelje të nenit 19 të LFSP dhe si rezultat kjo shkelje gjohet në përputhje me nënparagrafin 7, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.

Subjekti politik PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM, obligohet që pagesën ta kryejë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit për shqiptimin e gjobës përmes komunikimit zyrtar elektronik. Pagesa e gjobës duhet të dëshmohet përmes dorëzimit të kopjes së fletëpagesës në Zyrë.

Në rast të dështimit të pagesës së gjobës brenda afatit të dhënë si në pikën II të këtij vendimi, subjektit politik nuk i transferohen mjetet financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politik në shumë e gjobës së shqiptuar.

Nga sa u tha më lartë, Zyra vendos për shqiptimin e gjobës në vlerë prej katër mijë (4,000) euro, sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Prishtinë, 11.07.2024

Drejtori i Zyrës



Besnik Buzhala

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të subjektit politik PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM
- Përfaqësuesit të autorizuar financiar të subjektit politik PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM.

Këshilla juridike: Subjekti politik mund të inicojë padi kundër vendimit të Zyrës për shqiptimin e gjobave, pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, pas njoftimit për vendimin. Inicimi i padisë nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.